
TRIBUNA SINDIKALE

Qershor 2005

Dhe drit' e diturisë përpara do na shpjerë





Editorial

Çështjet më thelbësore për negocimin e Kontratës Kolektive

Nga Xhafer DOBRUSHI



Muaji qershor eshte periudha me intensive e procesit te negocimit per Kontraten e re

Kolektive te Punes, qe do te nenshkruhet midis FSASH e SPASH, nga njera ane, dhe Ministrise se Arsimit e Shkences, MASH, dhe Ministrise se Pushtetit Vendor e Decentralizimit, MPVD, nga ana tjeter, per nje periudhe te ardhshme 3 vjecare.

Bazen e negocimit midis sindikatave te arsimit dhe MASH e MPVD e perben Kontrata Kolektive ekzistuese. Te dy partneret, si sindikatat ashtu edhe punedhenesit, gjate ketyre viteve te fundit kane fituar nje pervoje te konsiderueshme ne perpunimin, perzgjedhjen dhe plotesimin e kerkesave qe jane fiksuar ne Kontraten Kolektive te Punes, perfshire edhe shtesat e permiresimet qe i jane bere asaj.

Por, duke u mbeshtetur ne Kontraten ekzistuese dhe ne pervojen e fituar, cilat do te jene ceshtjet me thelbesore, me te mprehta dhe me aktuale, qe kane terhequr me shume vemendjen e keshillave dhe seksioneve sindikale, dhe qe do te vihen ne qender te negocimeve?

Midis ketyre ceshtjeve ne do te vecojme kushtet e punesimit, kohen e punes, sistemin e pagave dhe rritjen e permiresimin e tyre, vjetersine ne pune dhe marredheniet me pushtetin vendor.

Çfare perfaqesojne dhe permbajne synimet dhe objektivat e sindikatave per secilen nga keto ceshtje ne krahasim me Kontraten Kolektive qe eshte sot ne fuqi?

Kushtet e punesimit, perfshire procedurat per emrimin e mesuesve, per vleresimin e punes se tyre, per levizjet dhe transferimet, per kualifikimin profesional dhe vleresimin e ngritjen ne pergjegjesi, perbejne bazen e nje kontrate kolektive. Ne Kontraten ekzistuese jane perfshire norma qe perbejne kritere konkrete per t'u punesuar ne arsim, sic jane mosha, niveli arsimor sipas cikleve, shkalla e kualifikimit, etj. Me kete kontrate u be nje hap perpara duke futur praktiken e konkurimit per vendet e lira te punes, si per mesuesit ashtu edhe per drejtuesit e shkollave, per te punesuarit ne zyrat arsimore dhe drejtorite arsimore rajonale. Kjo praktike ka filluar te funksionoje me mire ne disa drejtori arsimore, sic eshte ajo e Tiranes Qytet, Vlores, Fierit, Durresit, e ndonje tjeter.

Objekt i Kontrates se ardhshme do te jete perpunimi e percaktimi i kritereve me te plota e me te sakta per konkurimin. Ne percakimin e ketyre kritereve do te mbahet parasysh qe te shmangen ne maksimum qendrimet subjektive dhe te njeaneshme ne vleresimin e mesuesve qe konkurojne dhe kerkesat qe shtron procesi i reformimit e modernizimit te arsimit per mesues cilesor.

Ne menyre te vecante do te perpunohen kritere te sakta, ne baze te standarteve te sotme te Konventave Nderkombetare te Punes dhe te Kodit te Punes, per levizjet dhe transferimet ne arsim, duke kufizuar ne maksimum levizjet pa kriter, sidomos ato ne mes te vitit mesimor, ose levizjet qe behen sa here largohet nje titullar dhe vjen nje tjeter. Normat qe do te permbaje kapitulli i punesimit, do te synojne qe mesuesi te jete i garantuar ne punen dhe profesionin e tij, qe ai te mos behet pre e qendrimeve subjektiviste, hakmarrese, politike apo partiake. Ky kapitull do te perpunohet ne pershtatje me kerkesat dhe nivelin e Statusit te Mesuesit dhe do te sherbeje si baze per te.

PERMBAJTJA

Editorial:
- Çfare do te negocohet nga FSASH e SPASH per Kontraten e re 2
- Mbeshteten kerkesat e personelit ndihmes ne arsimin e larte 3
- Nga aktivitetet ne zbatim te Projektit AOB-FNV
- Nga seminari per punen me grate mesuese ne sindikate 3
- Nga seminari per punen me mesuesit e rinj ne sindikate 5
- Nga seminari zonal i Durresit 6
- Pjese nga Rekomandimi i ILO - UNESCO mbi Statusin e Mesuesit 8
- Nga aktivitetet e FSASH 10
- Nga aktivitetet e SPASH 12
- Puna e femijeve, objekt i rendesishem i sindikatave te arsimit 13
- Kur afron mbarimi i vitit arsimor.., *nga Murat Gecaj* 14
- Te reja shkencore dhe keshilla praktike *nga Eriona Vangjeli* 15

Kopertina e pare:
Perfaqesues te FSASH duke manifestuar me rastin e 1 Majit 2005
Kopertina e fundit:
Pjesemarreset ne seminarin per rolin e grave ne sindikate

TRIBUNA SINDIKALE
Nr. 14, Periodike
Botim i FSASH dhe SPASH
ADRESA: Bulevardi " Zogu i Pare "
Pallati Ali Kelmendi, kati III,
Tel: 22 83 46
Tel & Fax: 25 65 32

Keshilli Botues:
Xhafer Dobrushi,
Bajram Kruja,
Lumturi Mataj,
Defrim Spahiu,
Petref Çelaj,
Aleks Dushi,
Stavri Liko, **Kryeredaktor**

FSASH dhe SPASH mbeshtesin kerkesat e sindikatave te personelit ndihmes ne Arsimin e Larte

(Nga Konferenca per shtypin)

Ne nje Konference per shtypin dhene nga kryetari i FSASH, zoti Xhafer Dobrushi dhe Kryetari i SPASH, zoti Bajram Kruja, me prezencen edhe te perfaqesuesve te sindikatave te arsimit te larte, te kryesuar nga zoti Qazim Lataj, u be i ditur qendrimi i ketyre sindikatave ne mbeshtetje te kerkesave te Stafit jo Akademik (te personelit ndihmes) ne arsimin universitar dhe u shpallen masat dhe mjetet sindikale qe mund te perdoren per plotesimin e ketyre kerkesve.

Ne Konferencen e shtypit u theksua se, sic eshte bere e ditur nga Protokolli i Perbashket i nenshkruar me 9 dhjetor 2004, midis Grupit Nderministror dhe Komisionit Nderuniversitar te pedagogeve, rritja e pagave per personelin ndihmes ose per stafin jo akademik ne shkollat e larta do te behej brenda muajit mars 2005, me kryerjen e Studimit per piramiden e pagave dhe efektet e kesaj rritjeje do te shtriheshin nga 1 janar 2005.

FSASH dhe SPASH nuk kane marre pjese ne negocimin e kesaj Marreveshjeje, mbasi stafi akademik, perfshire punedhenesit, dekanet dhe rektoret, preferuan qe negocimi te mos behej nepermjet sindikatave.

Por, me qenese kane kaluar me shume se 2 muaj nga afati i percaktuar ne Protokollin e perbashket per rritjen e pagave te stafit jo akademik dhe deri tani nuk eshte zgjidhur asgje, pavaresisht se te dy sindikatat e arsimit, FSASH dhe SPASH, nuk kane qene pjese e ketij Protokolli, kane te drejten e ligjeshme, qe, ne emer te anetareve qe perfaqesojne ne arsimin e larte dhe vecanrisht ne stafin jo akademik, te kerkojne zbatimin me korrektesi te pikes 5 te Protokollit te siperpermendur.

Duke mbeshtetur kerkesat e drejta per rritjen e pagave te stafit jo akademik, te cilat deri me sot jane teper te uleta, FSASH dhe SPASH kerkojne nga Qeveria dhe Ministria e Arsimit dhe Shkences, qe menjehere, te miratojne aktet nenligjore perkatese per te materializuar Protokollin e Perbashket, ne menyre qe kjo kategori punonjesish te marrin shtesen e rritjes se pagave, sipas premtimit qe u eshte bere me Protokollin zyrtar te nenshkruar nga te dy palet.

Nese kjo nuk do te ndodhe, FSASH dhe SPASH, ne bashkepunim me strukturat e tyre sindikale ne fakultete dhe universitete, do te percaktojne mjetet sindikale per plotesimin e ketyre kerkesave.

Nga aktivitetet ne kuadrin e Projektit AOB - FNV

Grate mesuese, faktor i rendesishem ne sindikate

Nga seminari per punen me grate mesuese ne sindikate

Nga Stavri LIKO

Seminari treditor per punen me grate mesuese ne sindikate, qe u zhvillua ne Tirane ne datat 19, 20, 21 maj shenon nje moment te rendesishme per dy sindikatat tona te arsimit, FSASH dhe SPASH. Me prezencen e 25 grave drejtuese te organeve lokale dhe shkollave nga shume rrethe te vendit, ne seminar u diskutuan probleme te shumta qe kane te bejne me njohjen e gjendjes aktuale te grave si mesuese, si anetare te sindikatave dhe si drejtuese ne organet arsimore e ne sindikate.

Seminari ishte konceptuar si nje rrahje e lire e mendimeve per nxjer-

Vijon në faqen 4



Grate mesuese, faktor i rendesishem ne sindikate

Vijon nga faqja 3

jen e konkluzioneve dhe pergatitjen e nje plani veprimi per permiresimin e gjendjes ne te ardhmen e afert e ne perspektive.

Ne diten e pare seminari u drejtua me kompetence dhe metoda bashkekohore nga lektorja Fatbardha Keço, e cila kishte pergatitur nje sere materialesh ndihmese dhe i dha prioritet shqyrtimit te gjendjes aktuale per te percaktuar te ardhmen. Ne dy ditet ne vijim dy lektoret holandeze Trudy Kerperien dhe Claire Costriesland pasuruan me tej tematiken dhe metodiken e ketij seminari, duke e bere ate shume ineteresant dhe terheqes per



grate pjesemarrese. "Pjesemarrja jone ketu, sqaroi qe ne fillim Trudy, konsiderohet nje ndihme per sindikatat tuaja dhe per koleget tona mesuese per te realizuar synimet qe ju i keni vene vetes".

Shume aktive ishin ne seminar perfaqesueset e FSASH, Lumturi Mataj, Teuta Stepa, Nadire Proi, Violeta Poloska, Mira Halluni, Violeta Doko, si edhe perfaqesueset e SPASH, Reihan Shkreta, Teuta Çobaj, Nirvana Leka, Eliveta Pysqyli etj, te cilat jo vetem moren pjese gjallerisht ne diksutime ne seancat plenare e ne punen ne grupe, por edhe raportuan e shpjeguan konkluzionet e arritura gjate punes ne grupe.

Konkluzioni kryesor qe u arrit nga ky seminar ishte se ne lidhje me kete teme ka shume probleme, per zgjidhjen e te cilave nevojitet kohe, angazhim, perkushtim, objektiva te qarta, pune konkrete.

Nga pikepamja metodike, seminari ishte nje gershetim i shpegimeve teorike, me shqyrtimin e situates aktuale, evidentimin e prioriteteve dhe perpilimin e planeve te veprimit, duke punar ne seanca plenare dhe ne grupe. Ne ket kuader nje vend te rendesishem zuri njohja me pervojen holandeze, paraqitur me shume kujdes nga lektorja Trudy Kerperien, e cila evidentoi historine e zhvillimeve dhe ndryshimeve te medha ne lidhje me rolin e gruas ne shoqeri e ne sindikate ne Holande, duke filluar qe nga vitet '70.

E rendesishme eshte qe pervoja e punes ne Holande, nuk u konsiderua nje shablon qe duhet te zbatohet ne kushtet e vendit tone. Perkundrazi kjo pervoje dhe te gjitha diskutimet u pane te lidhura ngushte me situaten aktuale dhe kushte e vendit tone.

Moment shume i rendesishem i ketij seminari ishte percaktimi i prioriteteve te dy sindikatave tona te arsimit per punen me grate mesuese. Me kryesoret nder keto prioritete mund te permednen:

- Njohja me e mire e legjislacionit mbi poziten e gruas ne tregun e punes, angazhimi i sindikatave per te ndikuar ne permiresimet qe dikton koha per kete legjislacion, si edhe reflektimi ne kontraten kolektive te punes dhe ne Statusin e Mesuesit, ne lidhje me permiresimin e pozites se grave mesuese ne sistemin arsimor dhe ne sindikate.
- Ngritja dhe organizimi i strukturave te posacme per grate ne sindikate dhe mbeshtetja e tyre nga organet qendrore e lokale te te dy sindikatave, me synim organizimin e nje pune te vencante me grate mesuese per rritjen e numrit nte tyre ne sindikate dhe ne roganet drejtuese te sindikatave dhe te administratave te shkollave.
- Shkembimi i eksperiencave brenda rretheve, midis seksioneve te rretheve te ndryshme e me gjere ndikon shume pizitivisht ne permiresimin e kesaj pune ne te gjitha aspektet dhe krijon mundesi per ecje me te shpejt perpara.
- Trajnimi i grave drejtuese te grupeve dhe deri sgrave sindikaliste te thjeshta eshte nje priotitet qe shoqerohet me rezultate konkrete, ne nje kohe te shkurter, prandaj kjo gje u evidentua pothuajse nga te gjitha grupet.

Duke e vene theksin tek pergjegjesia e organeve drejtuese te sindikatave ne nivel qendror e lokal, seminari nxori si konkluzion edhe domosdoshmerine qe, se pari vete grate, duhet te luftojne per te permiresuar poziten e tyre ne sindikate e, me pas, edhe ne organet drejtuese te tyre.

Ne vijim te prioriteteve qe u percaktuan ne kete seminar, pritet qe te mbledhet grupi perkatese i punes, pak me vone te behet nje mbledhje me grate drejtuese lokale ne sindikate dhe ne vazhdim, ne pranveren e vitit te ardhshem, te zhvillohet seminari i dyte ne lidhje me kete ceshtje te rendesishme te veprimtarise se FSASH e SPASH.

Mesuesit e rinj, e ardhmja e sindikates

Nga seminari mbi punen me mesuesit e rinj ne sindikate



Seminari per punen me mesuesit e rinj ne sindikate, ku moren pjese 24 vajza e djem, mesues te dalluar dhe aktive ne sindikatat e arsimit, FSASH e SPASH, shenoi nje moment te rendesishem per keto sindikata. Pas nje pune intensive treditore, tani kemi nje grup te rinjesh te pergatitur, te afte dhe te gatshem qe te angazhohen, ne radhe te pare ne sindikatat e shkollave te veta, por edhe me gjere, ne shkollat e rretheve perkatese, per shtimin e mesuesve te rinj ne sindikate dhe rritjen e rolit te tyre per demokratizimin dhe ecjen perpara te sindikatave te arsimit.

Organizimi i seminarit ishte nje bashkepunim i lektoreve tane, te pergatitur me asistencen e sindikates holandeze te Arsimit, AOB, dhe lektoreve te kesaj sindikate, Marten Kircz e Ciska Pouw, te cilet paten nje ndikim efektiv ne mbarevajtjen e ketij seminari.

Prezenca e nderhyrjet e dy drejtuesve kryesore te FSASH e SPASH, Z. Xhafer Dobrushi e Bajram Kruja, beri qe diskutimet ne lidhje me gjendjen aktuale dhe detyrat afatshkurtera te ishin me konkrete dhe orientimi drejt problemeve me kryesore qe lidhen me kete ceshtje te ishte me efektiv.

Gjate dites se pare seminari u drejtua nga lektori i ri, gjithashtu pjesemarres ne seminar, Gentjan Mullaj, i cili ishte shume aktiv, konkret dhe kerkues per nje angazhim e pjesemarrje te gjere te te gjitheve ne diskutime e debate. Pas nje pune te kujdeseshme ne grupe, konkluzionet e paraqitura, ne emer te kater grupeve, per te dyja seancat evidentuan probleme te shumta ne lidhje me pjesemarrjen e te rinjve ne sindikata dhe rolin e ketyre te fundit per trajtimin ne menyre specifike te problemeve te tyre.

Ne diten e dyte, me prezencen e dy lektoreve holandeze, seminari kaloi ne nje aspekt tjeter te rendesishem; te rinjte mesues si profesioniste, si edhe te rinjte mesues dhe sindikata ne sherbim te tyre, ku u analizua situata ne lidhje me kete aspekt, nen moton "te shihemi ne pasqyre". Ne diten e trete pjesemarresit u njohen me pervojen e AOB ne punen me mesuesit e rinj dhe punuan me kujdes per nje plan veprimi konkret te te dy sindikatave tona per punen me mesuesit e rinj.

Gjate tre diteve te seminarit te gjithe moren pjese gjallerisht ne diskutimet e mendimeve, ne diskutime e ne debate, si ne seancat plenare, ashtu edhe ne punen ne grupe, ku u vu re objektivitet ne analizen e gjendjes aktuale, nje kuptim i drejte i detyrimeve te sindikatave per rolin e te rinjve ne arritjen e synimeve te tyre, si edhe nje perspektive e qarte dhe inkurajuese per per punen e sindikatave me mesuesit e rinj ne te ardhmen. Shume aktive e konstruktive ne mendime e propozime ishin sidomos, pjesemarresit, Gentjan Mullaj, Kozeta Berisha, Rajmonda Brari, Najada Hoxha, Elda Bulica, Drita Hasmuça, Florinda Çiftja, Merita Zeqaj, Ardian Martinaj etj.

Disa nga drejtimet me te rendesishme te kesaj pune ne te ardhmen e afert, ashtu sic u evidentua ne njeren nga seancat e seminarit, ishin:

- Perdorimi i metodave terheqese, (perfshire dhe nje angazhim me te mire te medias) per te informuar mesuesit e rinj, mbi synimet, punen dhe angazhimin e sindikatave per trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve te tyre.

- Terheqja e mendimeve te mesuesve te rinj dhe perfshirja e problemeve specifike te tyre ne kontraten e re kolektive te punes, duke kerkuar angazhimin e nje numri gjithnje e me te madh te ketyre mesuesve per te mbeshtetur sindikatat ne kerkesat per nje motivim me te mire te mesuesve e vecanerisht te atyre qe jane ne vitete e para te ketij profesioni ne gjithe sistemin arsimor.

- Rritja e kerkesave ndaj Ministrise se Arsimit e Shkences dhe organeve te tjera perkatese per nje sistem efektiv kualifikimi profesional te mesuesve te rinj.

- Te punohet me mire per kualifikimin sindikal te anetareve te sindikates nga radhet e mesuesve te rinj dhe te perdoren forma efektive per rritjen e prezences se tyre ne organet drejtuese te sindikatave.

Ne seminar u theksua nevoja per mbajtjen e kontakteve te vazhdueshme me kete berthame, tashme te pergatitur, per zgjerimin e saj dhe per organizimin e takimeve e perdorimin e formave te ndryshme, jo vetem nepermjet aktiviteteve ne kuadrin e projektit, por edhe me kontributet e vete sindikatave, me qellim qe puna te vije duke u forcuar dhe arritjet edhe ne kete drejtim te vijne duke u zgjeruar.



Organizimi sindikal dhe motivimi i mësuesve, bazë për forcimin e lëvizjes sindikale

Nga seminari zonal i Durresit



Në Shtëpine e Pushimit të punëtorëve në Durrës, u zhvillua seminari zonal treditor në kuadrin e Projektit me AOB - FNV, ku morën pjesë drejtues sindikalë lokalë nga rrethet Durrës, Krujë dhe Kavajë. Në Seminar moren pjese edhe dy drejtuesit kryesor të të dy grupimeve sindikale, FSASH e SPASH.

Seminari u drejtua nga një katërshe lektorësh të mirëpërgatitur në kuadrin e projektit të mëparshëm të AOB- NOVIB, i cili ka mbi tre vjet që përgatit lektor për të dy sindikatat. Drejtimi i një seance nga i riu Gentian Mullai bëri që të rritet besimi se ndryshimi me të vërtet fillon nga të rinjtë. Pasioni për punën për rritjen e kulturës sindikale u vu re tek Rolanda Dinci e cila trajtoi me kompetence temën për punën me gratë. Serioziteti i Neim Hajderaj në përgatitje bëri që diskutimi i temës mbi partneritetin social të kthehej në një debat shumë konstruktiv.

Të gjithë lektorët gjetën në këtë seminar një grup sindikalistësh që kohën e punës kërkonin ta shfrytëzonin në maksimum. Të pesë temat ishin menduar për t'u trajtuar me metodën e bisedës. Ishin lektorët që, me pyetsorët e përgatitur, bënë të mundur shfrytëzimin maksimal të kohës punës. Secili sindikalist u përgjigjej pyetjeve personalisht. Pyetsorët ishin shpesh provokues, ku secili duhet të tregonte vlerat e veta si mësues dhe si sindikalist. Metoda ndryshoi në atë problemore, efektet e së cilës pranohen si më të mira në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Për çdo temë, pas punës individuale, sindikalistët punuan në grupe. Kriteret e ndarjes në grupe ishin grupimi sindikal, kualifikimi, përvoja, seksi, mosha. Gërshetimi i këtyre faktorëve bëri që drejtuesit e seminarit të mos dallonin se kujt grupimi i përkiste sindikalisti. Puna ime, si drejtues i seminarit, u bë më e lehtë, pasi sindikalistët pjesëmarrës u çliruan nga grupimi sindikal dhe iu përkushtuan punës për seminarin. Mund të pohoj se për mua ka qënë seminari i parë pa komplekse grupimi.

Pasi u shpërnda pyetsori për temën "Si të organizojmë sindikatën në nivel lokal, në mënyrë që të shtojmë anëtarësinë", u bë një punë serioze në përgatitje. Ajo që të bintë më shumë në sy ishte, pas punës individuale, puna në grup. Secili pjesëtar i grupit raportonte për pyetsorin dhe përgjigjet e tij. Pas punës njohëse, realizohej përgjithësimi. Gjatë gjithë kohës lektorët ndihmonin në grup. Statusi i veçantë i tyre ishte ndihma për të mos lejuar daljen nga tema. Nuk lejonin që të merreshin me probleme anësore. Të kërkosh nga mësuesit që të punojnë kështu, është sa e vështirë aq dhe e bukur. Puna bëhet e lehtë për nivelin e tyre të përgatitjes. Duam të theksojme preokupacionin e grupit të dytë ku merrnin pjesë Përparimi, Violeta, Myzaferi dhe Bujari. Raportimet mbi konkluzionet u realizuan nga Artur Fetahu, Muharrem Shqarri, Artan Malasi, Përparim Musabelliu.

Gjendja e tanishme u vlerësua prej tyre si jo



e mirë. Secili tregoi se organizimi është i domosdoshëm. Sa më shpejt të bëhet anëtarësimi, aq më shumë rezultate do të kemi në kërkesat tona. Prioritet, sipas tyre, është organizimi jo formal. Mësuesi duhet të shohë tek sindikata mbrojtësen dhe realizuesen e kërkesave. Sa është arritur kjo nga sundikata u trajtua nga Z. Xhafer Dobrushi në fillim të ditës së parë. Për detyrat në vazhdim, pati shumë diskutime. Një sindikalist i mirë duhet të njoh Statutin. Nuk pretendojmë se të gjithë duhet të njohin Kodin e Punës dhe KKP, por kryetari i rrethit dhe shkollës nuk mund të punojnë pa i njohur ato. Si mund t'i thuash një mësuesi anëtarësohu në sindikatë, kur vet nuk je i qartë për të. Në përfundim, theksi u vu në kualifikimin e të zgjedhurve. Pa kualifikim, nuk mund të ecet para. Bëmë soparimin se anëtarësimi nuk mund të bëhet në copa letre e as të kemi anëtarë për formë. Situatat kanë ndryshuar nga një vit në tjetrin. Punëdhënësi kërkon partner real. Partneriteti nuk është vëtëm në kupolat sindikale. Ai fillon nga shkolla e rrethi. U theksua se tani SPASH ka para fushatën e zgjedhjeve. Në krye të çdo organizate sindikale duhet të jenë mësuesit më të mirë.

Në fund u bë përgjithsimi për problemet kryesore që çdo grup i kishte vlerësuar si të tilla. Nuk mund të anashkalonim mendimet që ishin me shumë vlerë, pavarsisht se ishin bërë nga një grup apo ishte mendim i një individi. Kjo metodë jo vetëm që e gjallëroi më shumë seminarin por mendoj se i futi në një garë konkurence grupet e punës.. Çdo grup më pas e rriti në mënyrë të dukshme rezultatin e punës tij.

Motivimi i mësuesve dhe roli i sindikatave për përmirësimin e situatës në këtë drejtim, strategjia e arsimit, pjesëmarrja e sindikatave ne këtë proces ishte tema tjetër që u zhvillua ditën e parë. Për temën u aktivizuan shumë pjesëmarrës. Është detyrë e organizatave sindikale që, pas mirëorganizimit e mirëfunksionimit, prioritet të jetë motivimi i mësuesve. Puna që bëjmë ishte në konkluzionet e paraqitura nga Violeta Doko, Luljeta Vathi, Merita e Vladimiri është e bukur, fisnike, e lodhshme, e papagueshme. Nuk arrin mësuesi të jetojë normalisht. Ka shume mësues që punojnë roje apo kamarjer. Niveli i shollës ka rënë. Ka mësues që përgatitjes i kushtojnë shumë pak apo aspak vëmendje. Nuk është e mirë, por është pjesë e realitetit. Shume të rinj nuk kthehen si mësues pas mbarimit të shkollës në këtë profil. Ndoshta, u theksua në prioritetet për të ardhmen, do të ishte mirë që të vendosej në ligj se sa duhet të punosh për shoqërinë dhe pastaj të largohesh nga arsimi. Fakti që 28 % e mësuesve janë pa arsimin përkatës bën që analfabetizmi që ka filluar do të ketë problem më tej. Shumë firma u theksua se marrin punëtorë të kualifikuar nga jashtë dhe të rinjtë tanë rrinë pa punë. Nuk kanë kualifikim e as preokupacion për t'iu përshtatur ekonomisë së tregut. Ky është difekt jo vetëm i shoqërisë, por edhe i shkollës. Ndoshta duhen ripar me shpejtësi programet, duke iu përshtatur më mirë kërkesave të ekonomisë. Sindikalistët ngrejnë shqetësime që nuk e motivojnë mësuesin për punë, por e largojnë atë. Mësuesët shpesh shkojnë në punë me makina jo të mira. U mbahet taks dhe sigurime shoqërore edhe për lekët që marrin si vështirësi pune larg familjes. Paguajnë shoferët që t'i marrin për në punë. Tarifat për transportin janë ulur, ndërkohë që çmimi i naftës është rritur. Ky paradoks ka dy vjet që lulëzon, por asnjë nuk po e merr seriozisht. Ka shkolla pa xhama apo që u pikon çatia. Akoma nuk bëhët fjalë për ngrohje. Në shkollë janë futur dukuri e fenomene të panjohura më parë. Për to përgjregjësimban shoqëria, shteti familja dhe shkolla. Nuk po zbatohet strategjia e arsimit.

Vijon në faqen 7

Vijon nga faqja 6

Në shkollë fut hundët politika. Bëhen investime atje ku nuk janë të nevojëshme, vetëm se i duhet bërë qejfi i deputetit apo ndonjë tjetri me përgjegjësi.

Në këto kushte, sindikatat duhet të programojnë punën që të ndihet fuqishëm zëri i tyre. Reforma në arsim në parim ka filluar. Pjesëmarrja e sindikatave në emrime hodhi një hap. Besueshmëria kështu rritet. Kishte dhe sindikalist që nuk dinin se në konkurs për vende pune të pranishme ishin kryetarët apo të zëvendësit e tyre. Natyrisht bëhet fjalë për ata që sindikata i ka në letra dhe jo në punë.

Puna në grup nxori një mori kërkesash për motivimin e mësuesit. Ato u klasifikuan në shumë të rëndësishmë për momentin dhe probleme që mund të zgjidhen në vazhdimësi. Po ashtu roli që duhet të luajnë sindikatat u vlerësua me shkallë. Ka probleme që zëri duhet të jetë sot i fuqishëm, por ka dhe të tjera që me kohë do zgjidhen.

Në seminar u hap horizont dhe u treguan rrugët për të ardhmen. Por në shtator apo në fillim të tetorit me pjesëmarrësit duhet parë se si i kanë zbatuar në praktikë njohuritë e fituara. Eshtë detyrë e grupimeve apo e seksioneve për të bërë shpejt bilancin e punës, duke e krahasuar me të sotmen. Ndryshimi fillon nga të kualifikuarit dhe vazhdon në masën e sindikalistëve dhe mësuesve.

Petref ÇELAJ
Lektor i FSASH

Partneriteti real kerkon sindikate te organizuar

Diskutimet per temen qe lidhje me bashkepunimin me Drejtorite Arsimore dhe administratat e shkollave u bene ne lidhje te ngushte me me situaten dhe problemet konkrete aktuale ne seksionet dhe keshillat sindikale te shkollave, duke bere edhe propozime konkrete per permiresimin e merdhenieve te bashkepunimit me keto organe.

Tema u punua ne aspektin praktik, me shpjegime konkrete, duke iu referuar edhe Kodit te Punes dhe Kontrates Kolektive te Punes.

Puna ne grupe iu dha mundesine gjithe pjesemarresve qe te shprehnin mendimet e veta fare hapur dhe te realizohej nje debat konstruktiv, duke vene ne dukje mangesite dhe duke nxjerre konkluzione per nje pune me fektive ne te ardhmen.

Pergatitje te mire reflektuan sidomos Artan Malasi, Artur Fetahu, Violeta Doko, Merita Kertusha, si edhe Ardian Minxholli, Nirvana Kadiu, Drita gjinali, Luljeta Vathi, Vladimir Nelaj etj, te cilet theksuan domosdoshmerin e forcimit te bashkepunimit midis seksioneve sindikale te rretheve Durres, Kavaje e Kruje me Drejtirine Rajonale dhe Zyrat Arsimore, sie dhe me drejtoirte e shkollave, si nje kusht per forcimin cilesor te shkolles dhe mbrojtjen me te mire te anetareve te sindikates.

Ne seminar mori pjese edhe Drejtori i Zyres Arsimore te Kavajes, zoti Sulejman Dakoli, i cili solli pervojen e funksionimit normal te mardhenieve me seksionin sindikal te ketij rrethi per zgjidhjen e problemeve qe dalin ne procesin e zbatimit te detyrave qe kane te bejne me kushtet e punes dhe infrastrukturen ne shkolla, transportin e mesuesve, pagat dhe shperblimet e ndryshme, kualifikimin etj. Ne



fjalen e vete ai vuri ne dukje se edhe sindikalistet dhe drejtuesit e sindikatave duhet te kuptojne mire pergjegjesine qe kane para mesuesve, per mbrojtjen e tyre brenda gjithe kuadrit ligjor.

Nga diskutimi gjeresisht i kesaj teme u arrit ne konkluzionin se partneriteti real kerkon sindikate te organizuar, te orgnaizuar mire dhe drejtues te perkushtuar e korrekt ne detyre.

Neim HAJDERAJ
Lektor i FSASH

Rritja e pjesmarrjes se grave mesuese ne sindikate



Me mjaft interes u ndoq nga pjesemarresit dhe tema mbi punen me grate mesuese dhe rolin e tyre ne sindikate. Kjo teme u zgjodh me perparesi nga grupi i lektoreve, pasi eshte mjafte i njohur fakti qe pjesa me e madhe e mesueseve ne Shqiperi jane femra dhe se ato jane te perkushtuara ne kryerjen e detyres fisnike si mesuese dhe edukatore.

Pasi u njohen me temen ne pergjithesi, pjesemarresit u ndane ne grupe te vogla nga 4-5 anetare cdo grup, duke punuar ne menyre individuale e ne grup, duke debatuar e duke dhene mendime mjaft te vlefshme rreth temes se paraqitur.

Nga puna e organizuar ne grupe u ngriten mjaft probleme. U diskutua vecanerisht per nevojat e vecanta qe kane mesuesett femra, si mund te ndikoje sindikata per nje motivim me te mire, me qellim permiresimin e mireqenies se tyre, sa ndihet e mbrojtur femra ne sindikate, sa argetohet ajo, nepermjet aktiviteteve qe zhvillon sindikata, si mund te rritet pjesemarrja e grave ne drejtim ne administratat e shkollave dhe ne organet drejtuese te strukturave sindikale? Pjesemarresit u treguan shume aktive ne diskutimet e tyre, vecanerisht ato femra. Duke ndjekur me interes diskutimet dhe problemet e ngritura nga pjesemarresit, u evidentuan te metat dhe dobesite qe ekzistojne sot dhe datyrat qe u dalin sindikatave ne permiresim e punes ne ne te ardhmen.

Per kete u hartua nje plan veprimi, me objektiva e strategji konkrete, ndermjet te cilave mund te permenden: Rritja e numrit te anetareve femra ne sindikate, me rreth 30% Ne zgjedhjet e reja te synohet per rritjen e numrit te drejtuesve femra ne strukturat sindikale, te zhvillohen me shume aktivitete per terheqjen e sa me shume Femrave mesuese ne sindikate, si trajnime , takime, tema, biseda ne Tv , aktivitete argetuese etj, te pasqyrohen keto aktivitete ne mediat e shkruara dhe vizive.

Sigurisht qe hapi i pare u hodh, por mobilizimi i te gjitha keshillave e drejtueseve sindikale, nje pjese e te cileve ishin dhe pjesemarres ne kete seminar, do te jete hapi vendimtar per te bere realitet rritjen e pjesemarrjes se ne sindikate, si edhe ne organet drejtuese te sindikates dhe ne shkolla.

Rolanda DINÇI
Lektore e SPASH

Pjese nga Rekomandimi i ILO - UNESCO mbi Statusin e Mesuesit

Kapitulli IX

KUSHTET PËR MËSIMDHËNIE DHE TË MËSUAR EFEKTIV

Përderisa mësuesi është një specialist i çmueshëm, puna e tij duhet organizuar dhe ndihmuar në mënyrë të tillë që të shmangë shpenzimet e kota të kohës dhe energjisë.

Madhësia e klasës

Madhësia e klasës, (numri i nxënësve në klasë), duhet të jetë e tillë që të lejojë mësuesit për t'u kushtuar nxënësve vëmëndje individuale. Herë pas here mund të jepen klasa për mësim në grup të vogël apo me individë me qëllime të tilla si shmangia e praparbetjes, ashtu si jepen edhe klasa për mësim në grup të madh ku të përdoren mjetet audiovizive.

Personeli ndihmës

Me qëllim që t'u bëhet e mundur mësuesve të përqëndrohen në detyrat e tyre profesionale, shkollat duhet të kenë personel ndihmës që të bëjë punën jo mësimdhënëse.

Mjetet ndihmëse mësimdhënëse

(1) Autoritetet duhet të pajisin mësuesit dhe nxënësit me mjete ndihmëse moderne për mësimdhënien. Mjete të tilla nuk duhen trajtuar si zëvendësuese të mësuesit, por si mjete të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe shtrirjen e saj në një numër të madh nxënësish dhe në të mirë të arsimit.

(2) Autoritetet duhet të nxisin punën kërkimore lidhur me përdorimin e mjeteve të tilla dhe të inkurajojnë mësuesit për një punë të tillë.

Orët e punës

Orët gjatë të cilave mësuesve u kërkohet të punojnë në një ditë apo në një javë duhet të caktohen në konsultim me organizatat e mësuesve.

Në caktimin e orëve të mësimit duhen marrë parasysh të gjithë faktorët që lidhen me ngarkesën e punës së mësimit si:

a) Numri i nxënësve me të cilët mësuesi punon në ditë apo në javë;

b) Nevoja për të pasur kohë për një planifikim të përshtatshëm, për përgatitjen e mësimeve dhe vlerësimin e punës;

c) Numri i lëndëve të ndryshme që i është caktuar çdo ditë;

d) Kërkesat për kohën e mësuesit e nevojëshme për pjesëmarrje në punë kërkimore, për aktivitete të ndryshme, për detyra drejtuese dhe për konsultimet me nxënësit;

e) Dëshira për venien në dispozicion të një kohe gjatë së cilës mësuesit mund t'u raportojnë dhe të konsultohen me prindërit në lidhje me përparimin e nxënësve.

Mësuesve duhet t'u jepet kohë e nevojshme për të marrë pjesë në programe kualifikimi në arsim.

Pjesëmarrja e mësuesve në aktivitetet jashtëshkollore nuk duhet të përbëjë një barrë të tepërt dhe nuk duhet të pengojë kryerjen e detyrave krye-



sore të mësuesit.

Mësuesve të cilëve u caktohen detyra të veçanta në arsim, përveç punës mësimdhënëse, duhet t'u bëhet shkurtimi i nevojshëm në orët e mësimit.

Pushimet verore me të drejtë page

Të gjithë mësuesit duhet të gëzojnë të drejtën e një pushimi vjetor të përshtatshëm me pagë të plotë.

Leje për studim

(1) Mësuesve duhet t'u jepet leje për studim me pagë të plotë apo të pjesëshme dhe në intervale të caktuara.

(2) Periudha e lejes së studimit duhet të llogaritet në vjetërsi dhe në pension.

(3) Mësuesit e zonave që janë larg qendrave të populluara dhe që pranohen si të tilla nga autoritetet publike duhet të marrin më shpesh leje studimi.

Leje e veçantë

Leja për mosparaqitje në punë, që jepet brenda kuadrit të shkëmbimeve kulturore bilaterale apo multilaterale, duhet të konsiderohet punë në arsim.

Mësuesve që u caktohen projekte të asistencës teknike duhet t'u jepet leje për mosparaqitje, ndërkohë që duhet të mbrohen në vendin e tyre të drejtat e vjetërsisë, e ngritjes dhe e pensionit. Përveç kësaj, duhen bërë përgatitje për të mbuluar shpenzimet e tyre të mëdha.

Mësuesit e huaj të ftuar, po ashtu, duhet të marrin leje për mosparaqitje në punë nga vendi i tyre dhe t'u ruhet e drejta e vjetërsisë dhe e pensionit.

(1) Mësuesve duhet t'u jepet leje e rastit me të drejtë page të plotë për t'u krijuar atyre mundësinë që të marrin pjesë në aktivitetet e organizatave të tyre.

(2) Mësuesit duhet të kenë të drejtë të zenë vende pune në organizatat e tyre; në raste të tilla emërtimet e tyre duhet të jenë të ngjashme me mësuesit që punojnë në zyra publike (shtetërore).

Mësuesve duhet t'u jepet leje me të drejtë page të plotë për arsye personale të përshtatëshme, sipas kushteve specifike para marrjes së tyre në punë.

Leje për sëmundje
dhe për lindje

(1) Mësuesve duhet t'u jepet leje për sëmundje me të drejtë page.

(2) Në përcaktimin e periudhës gjatë së cilës do të jepet pagë e plotë apo e pjesëshme, duhet të merren parasysh rastet kur është e nevojshme që mësuesit të jenë të izoluar nga nxënësit për periudha të gjata.

Duhen zbatuar standartet e përcaktuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës në fushën e mbrojtjes së grave që lindin dhe në veçanti nga Konventa e Mbrojtjes maternitare (e rishikuar) 1952, si edhe standartet e rekomanduara në paragrafin 126 të këtij Rekomandimi.

Gratë mësuese që kanë fëmijë duhen inkurajuar që të mbeten në arsim, me anë të masave të tilla si bërja e mundur që ato, sipas kërkesës së tyre, të marrin leje pa të drejtë page deri në një vit pas punës dhe duke u ruajtur të gjitha të drejtat që burojnë nga ky punësim.

Shkëmbimet kulturore të mësuesve

Autoritetet duhet të njohin vlerën e shkëmbimeve profesionale dhe kulturore ndërmjet vendeve të ndryshme, si për shërbimin arsimor, ashtu edhe për vetë mësuesit, si edhe vlerën e udhëtimeve jashtë shtetit nga ana e mësuesve; ato duhet të përpiqen për t'i zgjeruar mundësi të tilla dhe të marrin parasysh përvojën e fituar jashtë shtetit nga mësues të veçantë.

Zgjedhja për shkëmbime të tilla duhet bërë pa diskriminim dhe personat në fjalë nuk duhet të konsiderohen si përfaqësues të ndonjë pikëpamje politike të veçantë.

Mësuesve që udhëtojnë për të studiuar apo punuar jashtë shtetit duhet t'u krijohen lehtësirat e përshtatëshme për këtë dhe t'u ruhen postet dhe statusi i tyre.

Mësuesit duhet të inkurajohen për të shkëmbyer përvojën mësimdhënëse të fituar jashtë shtetit me anëtarë të tjerë të këtij profesioni.

Ndërtesat e shkollave

Ndërtesat e shkollave duhet të jenë të sigurta dhe tërheqëse në projektim dhe funksionale në shtrirje; ato duhet t'i shërbejnë mësimdhënies efektive dhe përdorimit për aktivitete jashtë mësimore dhe, veçanërisht në zonat e fshatrave, duhet të shërbejnë si qendra komunitare; ato duhen ndërtuar në përputhje me standartet sanitare dhe të kenë qëndrueshmëri, përshtatshmëri (mundësi përshtatje), dhe mirëmbajtje të lehtë dhe pa shpenzime të tepërta.

Autoritetet duhet të sigurohen që shkollat të mirëmbahen siç duhet, në mënyrë që të mos kërcënohen në asnjë mënyrë shëndeti dhe siguria e nxënësve apo mësuesve.

Në planifikimin e shkollave duhet marrë parasysh opinioni i mësuesve. Kur janë për t'u bërë modifikime ose shtesa të reja në shkollat ekzistuese, duhet konsultuar me personelin e shkollës përkatëse.

Kritere të veçanta për mësuesit e zonave dhe të fshatrave të largëta

(1) Strehimi i pranueshëm, i cili mundësisht të jetë falas apo qera e ulur, duhet t'u sigurohet mësuesve dhe familjeve të tyre në zonat larg qendrave të populluara që pranohen si të tilla nga autoritetet publike.

(2) Në ato vende (fshatra) ku mësuesit, përveç detyrës së tyre normale të mësimdhënies, duhet të nxisin dhe punojnë për aktivitetet komunitare, planet e zhvillimit dhe programet e tjera, duhet siguruar një akomodim i përshtatshëm për mësuesit.

(1) Kur emërohen apo transformohen në shkolla në zona të largëta, mësuesve duhet t'u mbulohen shpenzimet e shpërnguljes dhe udhëtimit për vete dhe familjen.

(2) Mësuesve në zona të tilla duhet t'u krijohen lehtësira të veçanta udhëtimi që t'u mundësojnë ruajtjen e standartit profesional.

(3) Mësuesve të transferuar në zona të largëta duhet t'u paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit nga vendi i punës në qytetin e tyre njëherë në vit, kur ata shkojnë me leje.

Kur mësuesve u paraqiten vështirësi të veçanta, ata duhet të kompensohen, nëpërmjet shpërblimeve për vështirësi të veçanta që duhet të përfshihen në të ardhura dhe të llogariten për pension.

Nga aktivitetet e FSASH

FSASH merr pjese ne manifestimet e 1 Majit dhe ne Javen e Aktiviteteve Globale per Arsimin

Manifestimet e 1 Majit sivjet u gershetuan me aktivitetet e shumta qe u organizuan ne kuadrin e Javes se Aktiviteteve Globale per Arsimin. Ne kete kuader, gjate muajit prill, duke patur parasysh edhe orientimet e dhena nga Federata Nderkombetare e Arsimit, EI, (Education International), u organizuan biseda te shumta me drejtues lokale dhe trajnues, pjesemarres ne seminaret e organizuara ne Shkoder, Tirane, Mat dhe Durres, ku, ne prezence te nje mase te madhe drejtuesish sindikaliste, u fol per rolin e sindikatave te arsimit ne realizimin e objektivave te Mileniumit per arsimin, per demokratizimin dhe modernizimin e sistemit arsimor ne vendin tone, per nje arsim cilesor per te gjithe dhe per ceshtje te tjera qe kane te bejne me mbrojtjen e mesuesve.

Ne kete kuader, ne shume organizata sindikale u shperndane materiale te shumta propagandistike, te ardhura nga EI ose te botuara ne Revisten "Tribuna Sindikale"



e ne Gazeten "Pasqyra", ne te cilat behen te ditura objektivat ne nivel europian e boteror per zhvillimin e arsimit dhe synimet e strategjise se arsimit ne vendin tone per nje periudhe afatgjate, deri ne vitin 2015.

Nje vend te vecante zune problemet e Javes se Aktiviteteve Globale per Arsimin ne takimin qe u organizua ne Tirane, me drejtuesit e keshillave sindikale te shkollave, ku krahas trajnimit per nje pune me te kualifikuar sindikale, u trajtuan edhe problemet e angazhimit me te mire te sindikatave dhe forcimit te bashkepunimit te tyre me adminsitratat e shkollave, per mbarevajtjen e procesit mesimor dhe realizimin e objektivave te sistemit arsimor ne vendin tone.

Shume aktiv ishte grupi i FSASH edhe ne manifestimet qe u organizuan ne Tirane, ne kuadrin e Konfederates se Sindikatave te Shqiperise, me rastin e 1 Majit. Parrullat: "Arsim publik cilesor per te gjithe", "Jo me pak se 4 perqind te GDP per arsimin", "Paga me te larta, dinjitoze per mesuesit", "Mesuesit duan Statusin e tyre" etj, binin ne sy gjate ketij manifestimi.

Pjesemarrja masive e mesuesve dhe drejtuesve te sindikatave te te gjitha niveleve nga Tirana dhe nga disa rrethe te vendit, ishte nje tregues i qarte i angazhimit me te mire te vete mesuesve per te mbrojtur te drejtat e tyre dhe per te mbeshtetur FSASH ne veprimet e saj per mbrojtjen e anetareve dhe per zhvillimin demokratik te sistemit arsimor ne vendin tone.

Kerkohet me shume pergjegjesi e perkushtim

(Nga takimet ne seksionet e FSASH te rretheve te Jugut)

Ne vazhdim te veprimtarive per konsultimin me drejtuesit lokale te seksioneve e shkollave dhe percaktimin e detyrave konkrete afatshkurtera, Kryetari i FSASH, zoti Xhafer Dobrushi, organizoi keto dite disa Takime te tjera ne Seksionet Sindikale te FSASH ne rrethet e Gjirokastres, Sarandes e Delvines.

Ne Gjirokaster

Objekt diskutimi ishin gjendja e seksionit sindikal, problemet qe kane shoptesuar keshillat sindikale ne shkolla dhe masat urgjente qe duhen marre per konsolidimin e ketij seksioni. Kryetari aktual i ketij seksioni, zoti Shaqir Angoni, pasi paraqiti gjendjen e seksionit dhe disa veshtiresi me te cilat ballafaqohen drejtuesit lokal te ketij rre-



thi, shprehu optimizem ne riorganizimin e seksionit, duke u bazuar tek zgjidhjet qe jane ofruar nga Federata, duke realizuar rritjen e pagave ne sistemin parauniversitar me 1.1. 4 per qind per vitin 2004 dhe duke nenshkruar Marreveshjen me Qeverine per rritjen e pagave mesatarisht 15 perqind, duke filluar nga 1 shtatori i vitit 2005.

Zoti Xhafer Dobrushi kerkoi qe seksioni sindikal i Gjirokastres te riorganizohet, duke korrigjuar disa mangesi qe jane vene e vihen re keto kohet e fundit, sidomos ne drejtim te punes ne grup, te rritjes se pergjegjesise se drej-

tuesve ne te gjitha nivelet, te kontakteve me te shpeshta e me te drejtperdrejta me mesuesit, anetare ose jo te Federates dhe duke siguruar nje bashkepunim me te mire me Drejtorine Arsimore dhe drejtorite e administratat e shkollave. Ne vijim, ai shtroi detyren qe te rifreskohen drejtuesit e organizatave sindikale, duke ndjekur procedurat demokratike qe parashikon Statuti i Federates dhe te punohet per rritjen e numrit te anetarve qe zbatojne normat e Statutit, perfshire edhe pagesen e kuotes se anetaresise, e cila, megjithese simbolike, ndikon ne fuqizimin e Federates dhe kryrjen me te mire te detyrimeve ne te gjitha nivelet e saj.

Ne kete Takim u vendos qe nje grup dejtuesish lokale, perfshire kryetarin aktual, si edhe pjesemarresit ne kete Takim, Kujtim Dule, Llazi Duka, Fatmira Bizhga, Violeta Muka dhe Gligor Bezati, te ndermarrin disa veprime konkrete ne shkollat e qytetit dhe ne disa komuna per te bere permiresimet e nevojeshme, me synimin qe brenda muajit qershor, ne Gjirokaster te organizohet nje mbledhje me nje pjesemarrje te gjere te kryetareve te shkollave dhe aktivisteve te sindikates, ku te diskutohet per nje konsolidim te metejshem te strukturave sindikale dhe angazhimin e tyre per plotesimin e kerkesave social ekonomike te anetareve.

Ne Sarande

Takimi ishte me i gjere dhe vinte pas nje pune me te mire organizative qe ka bere kryetarja e seksionit, Zj. Neriman Gjivogli, e cila nuk ka shume kohe qe e ka marre kete detyre. Ne fjalen hyrese, ajo permendi shkollat "9 Tetori", "Adem Shehu", shkollen Ekonomike, ate te Ksamilit, te Gjashtes, te Konispolit etj, ku eshte bere nje pune e mire dhe sindikatat pothuajse jane riorganizuar, nderkohe qe po vazhdon puna edhe ne disa shkolla te tjera, per te ecur ne kete rruge.

Pjesemarresit ne takim bene shume pyetje, sidomos ne lidhje me angazhimet e Federates per rritjen e pagave ne sistemin parauniversitar, per problemet e vjetersise dhe te pensioneve, per qendrimet e drejtorive e te administratave te shkollave ndaj te drejtave sindikale dhe veprimeve te sindikatave per mbrojtjen e interesave te mesuesve etj, rreth te cilave u bene edhe shume diskutime konstruktive.

Zoti Xhafer Dobrushi vleresoi angazhimin e kryetares e te pjesemarresve ne kete Takim dhe pershendeti rezultatin e arritur, nderkohe qe beri nje prezantim te punes dhe arritjeve te Federates, sidomos gjate ketyre 6 muajve te fundit. Ai vuri ne dukje angazhimin e organeve drejtuese te saj ne qender e ne rrethe per zbatimin e detyrave qe shtroi Kongresi i Trete, i mbajtur ne Tirane, ne datat 5 dhe 6 nentor 2004, duke nenevizuar edhe bashkepunimin e frytshem me organizatat simotra ne Europe, sidomos Sindikaten e Mesuesve te Holandes, AOB.

Duke u ndalur tek problemi i bashkepunimit me Zyren Arsimore dhe administratat e shkollave, ai nenvizoi faktin qe pergjegjesia per kete gje eshte e dyaneshme. Nje partneritet real dhe efektiv me keto organe, kerkon nje seksion sindikal dinjitoz dhe qe vepron ne grup, per te mbrojtur interesat e mesuesve, ndryshe ky partneritet nuk mund te funksionoje sado kerkesa te bejme ne dhe sado



premtime te marrim nga keto organe. Ai nenvizoi rendesine e madhe te negocimeve qe jane ne proces me Ministrine eArsimit dhe Shkences per Kontraten e re kolektive te punes dhe Statusin e Mesuesit.

Zoti Xhafer Dobrushi pranoi kerkesen per me shume aktivitete kualifikuese me drejtuesit e sindikatave ne shkolla dhe premtoi se do te planifikohet nje aktivitet i tille, ndoshta rajonal, me pjesemarrjen edhe te drejtuesve te Gjirokastres e Delvines, ne te ardhmen e afert.

I pranishem ne kete takim, Kryetari i Keshillit Sindikal te KSSH per kete rreth, zoti Bardhyl Bejko, premtoi mbeshtetjen e ketij Keshilli per nje pune me te suksesshme te seksionit sindikal te arsimit ne kete rreth.

Ne Delvine

Riorganizimi i seksionit eshte ne hapat e para. I ngarkuari i Federates per kete qellim, Zoti Eduard Mehmeti, ka filluar nga puna pak kohe me pare dhe ka arritur rezultatet e para, por ne takimet qe u bene me perfaqesues te ketij rrethi u shkembyen mendime per nje pune me konkrete ne javet qe vijne, me qellim qe brenda qershorit te arrijme ne nje takim te zgjeruar me mesues, anetare dhe simpatizante te FSASH, ku te diskutohet konkretisht per shtimin e numrit te anetareve, organizimin e keshillave sindikale ne shkolla dhe te seksionit sindikal ne rreth. Per kete qellim u vune ne dispozicion edhe materialet perkatese, si Statuti i Federates, Revista "Tribuna Sindikale" etj.

Zoti Eduard Mehmeti pranoi se aktualisht jane te gjitha kushtet dhe mundesite qe edhe seksioni i Delvines te riorganizohet dhe t'u bashkohet seksioneve te sukseseshme qe veprojne ne kuadrin e FSASH ne shkalle vendi dhe kjo gje do te realizohet sipas afateve te percaktuara.

Zoti Xhafer Dobrushi premtoi mbeshtetjen e drejtperdrejte te strukturave qendrore e zonale te Federates, sidomos ne drejtim te zgjidhjes se disa problemeve specifike qe kane mesuesit e ketij rrethi.

Nga aktivitetet e SPASH

Partneriteti real, domosdoshmeri e sindikalizmit ne baze

Sa per te lidhur mendimet e mia, po e ilustroj me nje shembull. Gjate nje takimi ne nje nga rrethet ku merrnin pjese sindikaliste dhe drejtues te arsimit ne kete rreth, Drejtori i Drejtorise Arsimore te rrethit u shpreh se kishte marredhenie te mira me sindikatat, "I pres gjithnje perfaqesuesit e tyre", shtoi ai. Kete gje ai e konsideronte diçka te veçante dhe u habit kur ne i thame se kjo eshte pjese e detyres se tij, pjese e punes se tij. Nuk eshte qellimi qe te kritikojme dike, por te ritheksojme se partneriteti s'eshte bamiresi, por eshte detyrim ligjor. Ai nuk mund te konsiderohet si mundesi, miresjellje apo diçka tjeter e ketij lloji, por si nje hap drejt demokracise, drejt zhvillimit dhe perparimit te arsimit ne vendin tone. Qe partneriteti te institucionalizohet, hapi kryesor jane



Kontratat Kolektive te Nivelit te Dyte. Duhet thene se pothuajse ne te gjitha rrethet e vendit, te dyja sindikatat, mbeshtetur ne Kontraten Kolektive te Nivelit te Pare, kane lidhur Kontrata Kolektive te Nivelit te Dyte, duke siguruar partneritet ligjor me Drejtorite Arsimore. Lidhja e Kontrates eshte nje mundesi ligjore, e cila, neqoftese nuk zbatohet, kthehet ne nje formalitet i cili ndjehet se eshte gjalle kur zhvillohet greve dhe palet justifikojne veprimet e tyre ose ne Panele seminaresh ose forumesh, kur flitet per „suksese" nga te dyja palet.

Eshte e qarte se marredheniet e perditshme fillojne ne shkolle. Aty ku punohet drejtepersedrejti me nxenesit, aty dhe ndertohen marredheniet e para sindikate-drejtues shkolle. Neqoftese mesuesi ndjehet i mbrojtur nga kontrata ne kete pozicion, mund te themi se sindikata eshte funksionale. Qe te mbrohesh ne kete pozicion, detyrime drejtore shkollash dhe drejtues sindikatash, nepermjet te cilave te dyja palet te diskutojne rreth atyre gjerave qe, mbeshtetur ne kontrata, mund te ndertojne se bashku.

Sindikatat konsiderojne si pune te tyren çdo veprimtari qe ka te beje me zhvillimin e arsimit, me ndertimin e marredhenieve mesues-nxenes, kualifikimin e vazhdueshem te mesuesve, mbrojtjen e te drejtave te femijeve dhe te njeriut etj. E thene me shkurt, sindikata s'eshte thjeshte vetem mbrojtese e mesuesve, por partnere e te gjitha institucioneve, duke filluar nga Qeveria deri tek njesia e saj qe eshte shkolla, si partnere e te gjitha institucioneve qe mundesojne dhe sigurojne te ardhmen e vendit. Ky nuk eshte nje slogan por nje mundesi. Kete mund ta realizoje me se miri bashkepunimi sindikate-qeveri.

Ne pergjithesi, decentralizimi i arsimit eshte pjese e decentralizimit te pushtetit vendor. Marredheniet me Drejtorite Arsimore jane te kushtezuara dhe me kompetencat qe ato kane. E pare ne kete kendveshtrim mundesite mund te jene:

a. Mundesi institucionale (kompetenca e Drejtorise Arsimore), te cilat dhe sot jane te medha. Keto kompetenca kane te bejne me emerimet, transferimet, konkurimet e ndryshme per nje vend pune, marredheniet me Pushtetin Vendor dhe, ne pergjithesi, me komunitetin. Kjo marredhenie mund te zere vend ne Kontratat Kolektive te te dy Niveleve.

b.Mundesite profesionale, ku bejne pjese kualifikimet, marredheniet me prinderit dhe komunitetin, prezenca ne grupet e ndryshme te punes, duke filluar nga bordet e shkollave, perzgjedhjeve e vizioneve, misioneve, objektivave dhe ndertimi i strategjive kombetare e rajonale ne pergjithesi per zhvillimin e arsimit dhe rritjen e rolit te shkolles.

c.Mundesi ekonomike, qe kane te bejne me te gjitha shpenzimet qe behen per arsimin, duke filluar nga pagat e mesuesve, ndertimet, pajisjet, mundesite per te bere diferencime ne paga, rritje e pagave, argetim i femijeve dhe i mesuesve etj. Sindikatat duhet te jene pjese organike e te gjitha grupeve vendimmarrese qe jane te lidhura me problemet ekonomiko-shoqerore te mesuesve dhe nxenesve.

Kontratat gjithashtu duhet te permbajne rregulla detyrimisht te zbatueshme nga çdo mesues ne te mire te zhvillimit dhe perparimit te arsimit. Nepermjet kontratave, mbrohen te drejta, arrihen dhe fitore, por gjithashtu sanksionohen rregulli per te gjithe ata qe marrin persiper detyren e veshtire te mesuesit.

Ne kete periudhe jemi ne hartimin e draftit tone per Kontraten e re, prandaj eshte vendosur te terhiqet mendimi sa me i gjere i sindikalisteve. Riorganizimi i Drejtorive Arsimore ne baze Qarku ben te domosdoshme dhe organizimin sindikalist mbi kete baze, gje qe, me sa duket, po realizohet nga te dyja sindikatat. Decentralizimi sjell nje marredhenie me te mire ne baze shkolle, sidomos ne shkollat e medha ku Drejtoria, mesuesit, perfaqesuar nga sindikatat, dhe komuniteti mund te ndikojne seriozisht ne te gjitha problemet emergjente dhe afatgjata te arsimit dhe shkolles.

Aleks Dushi, Mesues Shkoder

Me shume vemendje levizjes sindikaliste ne Peshkopi

Peshkopia, ky qytet i vogel i ndodhur gjeografikisht aty nga verilindja e Shqiperise, duket sikur nuk njihet sa duhet. Paradoks, por e vertete (e dhimbshme). Ky qytet, plot tradita e virtyte, sot eshte lene ne harrese thuajse te plote.

Mora shkas te shkruaj diçka per qytetin, pas nje takimi qe bera me anetare e drejtues te SPASH e FSASH –it. Peshkopia vertete eshte nje qytet i vogel, por ka brenda njerez te medhenj, njerez qe perpiqen te punojne per zhvillimin e qytetit te tyre. Po permend ketu arsimin, sektorin aktual te punes sime. Qyteti ka 4 shkolla te ciklit 9-vjecar dhe 2 shkolla te mesme (te pergjithshme e profesionale). Angazhimi i mesueseve ne procesin mesimor eshte maksimal. Arsimi i tyre (rreth 90% i larte) flet qarte per pergatitjen e tyre profesionale.

Mesuesit dibrane, ashtu si tere mesuesit shqiptare, gjenden para nje sere pengesash , veshtiresish e burokracish, te cilat jo rralle sjellin pasoja tek vete femijet e adoleshentet.

Sindikata e arsimit ne qytet funksionon me rregull e disipline. Zhvillohen mbledhjet e zakonshme sindikaliste, ku secili shfaq hapur ide, mendime dhe i miraton apo i kundershton idete e tjetrit, gjithnje ne te mire te punes se mesuesit .

Duke qene nje qytet i vogel, pa shume mundesi argetimi e clodhjeje, u mireprit nga mesueset sindikaliste te qytetit ideja e krijimit te klubit sindikal. Shume mesues te aktivizuar me pare ne aktivitete te ketij lloji u mblodhen se bashku me mesueset sindikale, nen kenaqesine e te pirit te nje kafeje, diskutuan , qane halle e dhane ide se si mund te behej me mire per to. U hodh qarte ideja se levizja sindikaliste, duhet te gjeje cdo mjet e menyre progresive per te qene krahu i djathte i gruas mesuese, sidomos kur behet fjale per qytete te vogla, ku mentaliteti te mbyt. Qene mesueset, inisiatoret e greves se 2004-es. Ato treguan se dine te luftojne me cdo mjet e menyre demokratike perfshi ketu edhe greven, si shkalla me e larte e levizjes sindikaliste.

Perpjekje jane bere dhe po behen qe te rritet numri i mesueseve ne sindikaten e arsimit , si force aktive e arsimit dibran. E rendesishme eshte qe keto perpjekje te stimulohen , vlereshen e

Vijon në faqen 13

Puna e femijeve, objekt i rendesishem i sindikatave te arsimit

KONCEPTI MBI PUNËN E FËMIJËVE

Ka kohë që në shumë ambiente flitet gjërësisht e me shqetësim për punën e fëmijëve.

Po çfarë nënkuptojmë ne me "Punë e fëmijëve"?

Punë e fëmijëve nuk është rasti i punëve të vogla rreth shtëpisë, as pjesëmarrja e fëmijëve në punë të përshtatshme për nivelin e tyre të zhvillimit dhe që i lejon ata të përfitojnë aftësi praktike dhe të mësojnë të bëhen të përgjegjshëm. Puna e fëmijëve përfshin të gjitha punët të cilat nga natyra dhe kushtet në të cilat kryhen, dëmtojnë, abuzojnë dhe shfrytëzojnë fëmijët ose i privojnë ata nga arsimimi. Kjo do të thotë se puna e fëmijëve shfaqet në shumë forma kështu, është i nevojshëm një ekzaminim kritik i situatës së fëmijëve që punojnë, për të përcaktuar nga se përbëhet puna e fëmijëve dhe cilat janë format e saj më të këqija. Mënyra për të kryer këtë ekzaminim është e shprehur qartë në dy konventat kryesore të ILO-s në lidhje më këtë çështje, Konventa Nr. 138 dhe Konventa Nr. 182.

PROBLEMI I PUNËS SË FËMIJËVE AKTUALISHT

Puna e fëmijëve ka qenë prioritet i axhendës së organizatave dhe konferencave ndërkombëtare gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, megjithëse ky nuk është një fenomen i ri. Në shekullin e njezete, shpesh, si rezultat i fushatave të sindikatave, qeveritë miratuan legjislacionin për mbrojtjen e fëmijëve nga rritja e rreziqeve që industrializimi dhe urbanizimi sollën në marrëdhëniet e punës. Këto zhvillime, së bashku me legjislacionin për shkollimin e detyruar, përforcuan idenë që vendi i fëmijëve është në shkollë dhe jo në punë.

Kur u themelua ILO, në 1919, një nga çështjet themelore të organizatës ishte puna e fëmijëve. Konventa Nr. 5, e miratuar në 1919, trajton problemin e minimumit të moshës për punët në industri. Që atëherë janë miratuar disa konventa për moshën minimale të punësimit në degë të ndryshme të industrisë. Megjithatë, dy konventat kryesore të ILO-s që merren me punën e fëmijëve janë: Konventa Nr. 138, mbi Moshën Minimale të Punësimit, viti 1973 dhe Konventa Nr. 182, mbi Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve, viti 1999.

Është e rëndësishme të theksohet që këto konventa nuk janë të parat që njohin lidhjen midis



punës së fëmijëve dhe arsimit. Konventa Nr. 10, e miratuar në vitin 1921, e njihte tashmë këtë lidhje.

ILO ndan objektivat e saj nëpërmjet vendosjes së standarteve, mbrojtjes ligjore dhe bashkëpunimit teknik. Në vitin 1992 ILO miratoi një program kushtuar luftës kundër punës së fëmijëve. Ky program quhet Programi Ndërkombëtar i Eliminimit të Punës së Fëmijëve, IPEC. IPEC punon me qeveritë, punëdhënësit dhe sindikatat për të zhvilluar politika kombëtare dhe programe për të eleminuar punën e fëmijëve. IPEC lehtëson dialogun ndërmjet këtyre tri partnerëve në mënyrë që të arrihen objektivat kombëtare. Sot IPEC është një Program në Fokus i ILO-s që mbulon të treja metodat: vendosjen e standardeve, mbrojtjen ligjore dhe bashkëpunim teknik.

Partnerët social janë gjithashtu drejtpërdrejtë të përfshirë në luftën kundër punës së fëmijëve. ACTRAV, Zyra për Aktivitetet e Punonjësve ne ILO, i ka dhënë prioritet të lartë punës së fëmijëve. Dy projekte të ACTRAV, "Zhvillimi i Strategjive Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Sindikatës për të Luftuar Punën e Fëmijëve" dhe "Veprimi kundër Punës së Fëmijëve nëpërmjet Arsimimit dhe Trajnimit", po zbatohen në bashkëpunim me një numër të madh organizatash sindikale.

Zyra për Aktivitetet e Punëdhënësve, ACT/EMP, gjithashtu ka punuar për të rritur ndërgjegjësimin dhe veprimet e punëdhënësve mbi punën e fëmijëve.

Pavarësisht nga historia e gjatë e fushatave dhe legjislacionit, akoma mund të gjenden në vendet e industrializuara fëmijë që punojnë. Një ngritje në punën e fëmijëve mund të vëzhgohet në vendet e Europës Qendrore e Lindore, sepse ato lëvizën nga një ekonomi e centralizuar në ekonominë e tregut. Edhe në Shtetet e Bashkuara gjithnjë e më shumë fëmijë punojnë dhe kjo për shkak të rritjes së vrullshme të punëve me orar të pjesshëm dhe kërkesës për një forcë punëtore më fleksibël. Megjithatë puna e fëmijëve është më dominuese në vendet e paindustrializuara. Megjithëse është e pamundur të japësh shifra të sakta, ILO vlerëson se në vendet në zhvillim:

- 250 milion fëmijë midis 5 dhe 14 vjeç punojnë.
- Afërsisht 190 milion fëmijë që punojnë, janë midis 10 dhe 14 vjeç
- Afërsisht 120 milion fëmijë punojnë me kohë të plotë.
- Në Amerikën Latine mendohet se ka afërsisht 17.5 milion fëmijë që punojnë. Kjo shifër përfaqëson rreth 20% të fëmijëve në këtë rajon.
- Në Afrikë 40% të fëmijëve ose rreth 80 milion fëmijë punojnë.
- Azia ka 60% të fëmijëve ose afërsisht 153 milion fëmijë që punojnë.
- Numri i fëmijëve midis 14 dhe 18 vjeç që punojnë nuk dihet.

Këto statistika shërbejnë për të ilustruar se puna e fëmijëve është një problem i gjerë por vetëm këto nuk mund të përshkruajnë natyrën e këtij problemi.

SHKAQET KRYESORE TË PUNËS SË FËMIJËVE

Arsyet e punës së fëmijëve janë shumë dhe shkaqet e rasteve të veçanta të kësaj pune ndryshojnë nga një vend në tjetrin dhe nga një industri në tjetrën.

Megjithatë ka shkaqe të njëjta, ndër të cilat mund të përmenden:

Varfëria:

Varfëria konsiderohet shpesh si arsye kryesore për punën e fëmijëve. Familjet e varfëra i dërgojnë fëmijët e tyre për të punuar, në mënyrë që të rriten të ardhurat e familjes. Një numër i madh fëmijësh punojnë pa pagesë në fermat dhe dyqanet e familjes së vetë, për arsye se mbijetesa ekonomike varet nga puna e familjes në tërësi.

Dështimi i sistemit arsimor:

Shumë fshatra nuk kanë shkolla, sidomos në zonat e thella rurale. Në disa raste caktohen taksa të cilat prindërit nuk mund t'i paguajnë. Aty ku ka shkolla pa pagesë, cilësia mund të jetë e ulët dhe prindërit mendojnë se fëmija do të mund të mbijetojë në të ardhmen vetëm nëse ai/ajo punon dhe mëson një zanat.

Ekonomia informale:

Puna e fëmijëve është pak a shumë e zakonshme në shumë vende pune. Në ndërmarrje të vogla, të paregjistruara, që quhen shpesh sektori informal, puna e fëmijëve është më e shpeshtë. Inspektorët shkojnë rrallë në këto vende dhe aty nuk ka sindikata. Në kushte të tilla, puna e fëmijëve mund të lulëzojë shumë lehtë.

Kostoja e ulët e punës së fëmijëve:

Në ndërmarrjet e vogla informale, numri i të cilave është në rritje, puna e fëmijëve bëhet gjithnjë e më e përshtatshme, sepse ata mund të paguhen më pak se të rriturit. Përveç kësaj, punëtorët fëmijë nuk janë të organizuar dhe mund të disiplinohen më lehtë.

Mungesa e organizatave të punëtorëve:

Rastet e punës së fëmijëve janë më të shumta aty ku sindikatat janë të dobëta ose nuk ekzistojnë. Sindikatat nuk ekzistojnë përgjithësisht në sektorin informal, ku mund të jetë e vështirë për t'u organizuar.

Mungesa e mbrojtjes sociale:

Një numër i madh fëmijësh po zgjasin vargun e atyre që punojnë, sepse shoqëria nuk është në gjëndje t'u sigurojë mbrojtje të përshtatshme. Këtu përfshihen fëmijët e braktisur ose ata që kanë ngelur jetimë, për shkak të SIDA-s ose sëmundjeve natyrale dhe ata të rekrutuar si ushtarë në policitë private dhe ushtritë në zonat në konflikt.

Zakonet dhe qendrimet:

Në disa vende elita të fuqishme ose grupe të maxhorancës etnike konsiderojnë që të punosh është zgjedhja e duhur dhe natyrale për fëmijët e të varfërve ose fëmijët e minoritarëve etnikë. Ata nuk zotohen dhe nuk angazhohen që puna e fëmijëve të përfundojë por, në të kundërt, ata dëshirojnë të vazhdojnë të shfrytëzojnë këta fëmijë, për koston e ulët që ata kanë. Në rastet e tjera, kur prindërit kanë pak lekë për të harxhuar për edukim, ata zgjedhin të arsimojnë fëmijët meshkuj, kështu që vajzat janë shpesh të paarsimuara.

Vijon nga faqja 12

ç'eshte me e rendesishme te mos mbeten thjeshte perpjekje. Levizja sindikaliste e mesueseve dibrane di ta thote si duhet fjalen e saj. Lidhjet me sindikaten e arsimit ne qytet, me bahkine, Bordin e shkolles dhe Qeverine e Nxenesve, flasin qarte se gruaja dibrane ne pergjithesi e ajo arsimtare ne vecanti me frymen sindikale po integrohen gjithnje e me shume.

Zgjedhjet sindikale jane afer. Le te shpresojme qe ne kete fushate te zgjidhen sa me shume gra ne radhet e sindikates dibrane. Ato do te dine ta tregojne veten se jane pjese e se teres, pjese e levizjes sindikaliste, e levizjes qe di te perpiqet e t'u jape zgjidhje halleve te medha te arsimit dibran e arsimtareve te ketij rrethi.

Blerina Lala
Mesuese, Peshkopi

KUR AFRON MBARIMI I VITIT ARSIMOR...

(Në shkollën e mesme të përgjithshme "Arben Broci"-Tiranë)

1

Kisha disa arsye për të vizituar Shkollën e Mesme të Përgjithshme "Arben Broci" në kryeqytet. Së pari, është një institucion arsimor i njohur dhe me përvojë në procesin mësimor-edukativ. Së dyti, aty shër-ben drejtor z. Muharet Domi, djali



i mësuesit tim në vitet e para të pasçlirimit. Kishte ardhur si mësues i klasës së parë në shkollën fillore të Bujanit të Tropojës, nga një fshat i rrethit fqinj, Kukësit. Të gjithë ne, ish-vogëlushët malësorë të atyre viteve, e kemi ruajtur përherë me nderim në kujtesë mësuesin tonë të dashur Rifat Domi. Në udhën e tij eci me vendosmëri e pasion në detyrën e mësuesit edhe i biri. Për këtë gjë dëgjon të flitet nga mësues e nxënës të shkollës ku shërben tani. Por më erdhi mjaft keq, që nuk e takova atë në shkollën e tij, pasi kurohej në një klinikë jashtë shtetit. (Në faqen e parë të numrit të fundit të gazetës së shkollës ishin shkruar këto radhë prekëse: "I urojmë drejtorit të shkollës së mesme "Arben Broci" shërim të shpejtë! Ky urim është i të gjithëve, në pamundësi të ardhjes në spital).

Ndërsa ndien kënaqësi të natyrshme, kur vëren se punët e shumta të drejtor Muharetit i ndiqnin me përkushtim e korrektësi dy zëvendësdrejtoreshat, Valentina Prifti e Kostandina Mimani. Ato na dhanë informacione të pasura për jetën e punën e palodhur të kolektivit prej mbi 40 mësuesish e 1000 nxënësish të kësaj shkolle. Ndër këta, janë gjashtë klasa të viteve të para dhe pesë klasa me maturantë.

2

Ky kolektiv kompakt, me pikësynime të qarta dhe arritje të mira në procesin mësimor-edukativ, punon me moton: "Te vlerat vet-

jake, qytetare e shkencore të secilit prej nesh (mësues e nxënës) ndërtojmë vlerat e shoqërisë demokratike, të integruar në Europë".

Për arritjen e qëllimit të dëshiruar, vëmendje parësore është treguar që në fillim të vitit arsimor për sigurimin e një vijueshmërie sa më të

lartë. Kjo gjë është parë si kusht themelor për ndërtimin e tërë punës mësimore-edukative, organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive sa më të larmishme, në shkollë e jashtë saj. Si rrjedhojë, në tre vitet e fundit është zbritur ndjeshëm, shkallë-shkallë numri i mungesave të paarsyeshme në mësim. Me frytshmëri ka qenë njohja e rregullores së shkollës dhe e Akteve Normative nga nxënësit, mësuesit dhe prindërit. Pastaj është ngulmuar për zbatimin e detyrave nga çdo nxënës, por dhe sigurimin e të drejtave të tyre. Për këtë gjë ka një bashkëpunim të ngushtë me prindërit dhe tërë komunitetin, me të cilin janë zgjidhur mjaft çështje të tjera me interes të ndërsjellë dhe janë zhvilluar veprimtari të bukura e mbresëlënëse. Me ndikim pozitiv, sidomos për probleme të ndryshme edukative, ka qenë vendosja e psikologes në shkollë.

"Për ngritjen cilësore, - na tregoi znj. Mimani, - tërë kolektivi i mësuesve po i kushton kujdes përbërjes së nxënësve. Ata vijnë te ne nga disa shkolla 9-vjeçare të kryeqytetit dhe nga mjaft rrethe të vendit. Kuptohet se ata mbartin probleme të ndryshme, të cilat përpiqemi t'i zgjidhim me rrugë e forma të ndryshme pune. Mbi bazën e arritjeve të mëparshme e kemi organizuar punën edhe sivjet e synojmë që ta përfundojmë tërë vitin shkollor me tregues sa më të kënaqshëm. Objektivat i kemi konkretë, të realizueshëm dhe të matshëm...".

Vëmendje e dorës së parë i kushtohet këtu mësimdhënies e mësimnxënies, duke synuar që mos të ketë zbrazëti dhe, kur krijohen ato, të mënjanohen sa më shpejt të jetë e mundur. Një formë e efektshme kanë qenë analizat me grup-klasash e grup-lëndësh, ku janë trajtuar me përparësi problemet e viteve të para dhe të viteve të katërta. Kështu, është ndjekur me kujdes përparimi i maturantëve, që paraqesin boshllëqe, me synim që të gjithë të hyjnë në provimet e pjekurisë dhe të kalojnë. Këto ditë janë organizuar konsultime dhe përsëritje në lëndë të ndryshme, sidomos në lëndët letërsi, matematikë e fizikë, që janë provim. Atyre u qëndrojnë pranë të gjithë mësuesit, ndër të cilët veçohet puna e mirë e Piro Kitës në matematikë e Vjollca Fortuzit në fizikë. Ndër të tjera, mësuesit po i orientojnë maturantët se si të punojnë me testet, të cilat praktikohen në provimet e pjekurisë.

E lidhur ngushtë me suksesin përfundimtar është vlerësuar nga mësuesit kujdestarë dhe njohja e rregullores së provimeve, si nga mësuesit, nxënësit dhe prindërit.

3

Kjo shkollë është e dalluar dhe për organizimin e veprimtarive edukative, kulturore-artistike dhe fizkulturore-sportive. Ashtu si në procesin mësimor-edukativ, në këtë drejtim ka ndikuar për mirë dhe bashkëpunimi i drejtuesve të shkollës me sindikatat e arsimit. Veçanërisht u kanë qëndruar pranë artistëve të rinj mësuesit Resmie Bici e Roza Mosko. Në "Rin-Fest" nxënësit e kësaj shkolle merituan vendin e tretë ndërmjet shkollave të mesme të kryeqytetit, ndërsa në veprimtarinë "Maratona ekologjike" zunë vendin e gjashtë. Festivali i nxënësve të viteve të para u pëlqye dhe la mbresa te të gjithë shikuesit. Kjo lidhej dhe me faktin se pjesëmarrësit ishin veshur me rroba karakteristike të krahinave të ndryshme të Shqipërisë, nga vijnë nxënësit, si Tepelena, Kukësi ose Elbasani. Sigurisht, një gjë e tillë ka vlera të shumëfishta, pasi nxënësit argëtohen dhe njohin e ruajnë traditat e mrallа të popullit.

Po kështu mund të flasim dhe për veprimtaritë me rastin e "Ditës së Toleracës". Ndërsa për kalitjen fizike të nxënësve punojnë ekipet sportive, të cilat kanë fituar kupa e trofe në veprimtari të ndryshme.

Moresa të pashlyera kanë lënë te mësuesit e nxënësit dhe vizitat turistike në disa qytete të vendit, si në Durrës, Berat, Vlorë, Sarandë etj. Por kanë mbetur të paharruara dhe vizitat e ndërsjellta me mësuesit e nxënësit e shkollës "Eqrem Çabej" të Prishtinës. Këto ditë këtu erdhi nga drejtuesit e kësaj shkolle një ftesë për të marrë pjesë në festën tradicionale të përvjetorit të krijimit të saj.

4

Ndër duar kemi disa numra të gazetës mujore të kësaj shkolle, që mban emrin e Martirit të Demokracisë, Arben Broci. (Në fillim e kishte emrin "Demokracia"). Në faqet e saj tregohet se ajo e nisi jetën më 16 shtator 1992. Por, me gjithë moshën e re të saj, të gjithë janë krenarë për udhën e përshkuar dhe arritjet e deritanishme. Mësojmë se gazetën e nxjerrin me pasion, por dhe me vështirësi financiare, një grup nxënësish. Atyre u qëndrojnë pranë drejtuesit e shkollës dhe mësuesit e tyre.

Në faqet e kësaj gazete, për të cilën punojnë nxënësit A.Shahini, D.Çela, E.Bozo, G. Malo, F.Bylyku, B.Ymeri, M.Petraj, F.Sullaj e J.Kanini, gjen shkrime nga jeta e gjallë e shkollës, artikuj shkencorë, krijime të vetë nxënësve, kërshëri të ndryshme etj. Gjithashtu, gazeta po bëhet mxitje për pjesëmarrjen në konkursin e krijimtarisë letrare, që është shpallur disa kohë më parë nga Këshilli Britanik. Ai titullohet 'Pasioni, gjëja më e bukur e jetës sime".

...Në mbyllje të këtyre radhëve për mësuesit dhe nxënësit e shkollës së mesme të përgjithshme "Arben Broci" në Tiranë po përmendim një fakt domethënës: Çdo vit, rreth 50 përqind e maturantëve të saj vijojnë shkollat e larta të vendit. Të gjithë dëshirojnë që sivjet ky numër të rritet. Për këtë gjë jep shpresa dhe tërë puna përgatitore, që po bëhet gjatë kësaj periudhe deri në provimet e pjekurisë, si me nxënësit e viteve të katërta, por dhe në tërësi me ata të viteve të tjera. Prandaj të gjithë janë optimistë për arritje të reja.

Murat GECAJ

Të reja shkencore

KULLA DIELLORE



Dëshironi të keni energji të lirë? Australianët kanë një përgjigje të thjeshtë. Fillimisht ndërtoni një serë 20.000 akër (1 akër është rreth 4000 m2) për të "mbërthyer" dhe nxehur ajrin. Më pas, ndërtoni një kullë vigane 1 km të lartë dhe vendoseni atë në mes të serës. Ajri i nxehtë i serës do të ngrihet nëpërmjet kullës njësoj sikur ajo të ishte nje oxhak, duke prodhuar kështu energji të mjaftueshme për të furnizuar 200.000 shtëpi australiane. Mund të duket si një projekt fantastiko – shkencor, por ai është duke u përgatitur për tu aprovuar nga qeveria australiane. Nëse do të arrihet të ndërtohet, kulla 800 milion dollarshe do të jetë struktura më e madhe e krijuar nga njeriu në botë.

XHUPI MUZIKOR



Kur temperaturat bien, adhuruesit e muzikës, për të vënë në funksionim një CD player, janë shpesh të detyruar të zgjedhin midis zbërthimit të xhupit, duke ekspozuar veten ndaj të ftohtit të padurueshëm e rrezikut te acarimit të lëkurës, ose dëgjimit të të njëjtave këngë për orë të tëra. Me "xhupin muzikor" Burton, nuk është nevoja të zgjedhësh. I krijuar për të gjithë admiruesit e muzikës që merren me sporte dimërore, xhupit i janë vendosur në brendësi të tij, një mini-disk Sony dhe një CD player dixhital. Ju mund të zgjidhni muzikën që dëshironi, pa e hapur xhupin, por vetëm duke shtypur krahun, sepse funksionet e kontrollimit janë vendosur në mëngë.

SUPER "PJATAT"

Pjatat e mëdha të aluminit, të vendosura



në majë të altoparlantëve BeoLab 5, nuk janë thjesht për spektakël. Ato janë projektuar për të shpërndarë valët e larta dhe të mesme të tingullit, të prodhuara nga altoparlantët në formë koni. Ato mund të arrijnë maksimumin e kapacitetit të tyre, pa zhurmat e zakonshme jo aq të këndshme që dëgjojmë në këto raste. Për të siguruar që tingulli i altoparlantëve të jetë më i miri në çdo vend, këto "pjata" kanë një sistem të inkorporuar gradimi. Thjesht, mjafton të shtypësh butonin në majë të çdo altoparlanti që tingulli të shpërndahet automatikisht në mënyrë të barabartë.

Këto "pjata" janë rreth 2.500 vat secila.

TASTIERA VIRTUALE



Nëse monitorët e kompjuterave mund të transformohen në gjithçka, pse të mos ta bëjnë këtë edhe tastierat?

Shumë shpejt ato do të mund ta bëjnë këtë. Dy kompani kanë realizuar prototipe të tastierave virtuale, të dizenjuara për të shoqëruar kompjuterin, pajisje të tjera të transportueshme dhe telefona celularë. Ja si punon: një rreze lazeri projekton një skicë me një ngjyrë të kuqe të ndezur të një tastiere në një tavoline ose sipërfaqe të sheshtë. Një sensor si ato të një kamere dixhitale është përgjegjës për reflektimin e një drite infra të kuqe të projektuar në të njëjtin vend. Në të ardhmen, tastiera të ngjashme do të realizohen së bashku me pajisjen me të cilat punojnë, në mënyrë që të zhduken kur nuk përdoren.

Katër këshilla për t'u përqëndruar në punë

Mendoni pak për gjithë shpërqendrimet që keni kur punoni për të përfunduar një plan apo projekt. Me gjithë e-mailet, telefonatat apo ftesat të cilave duhet t'u përgjigjeni, është e çuditshme si mund të arrini të kryeni detyrat tuaja.

Këtu janë pesë këshilla për t'u përqëndruar në një botë me ndërprerje të vazhdueshme:

1.Planifikoni kohë kur jeni i padisponueshëm për asnjë dhe për asgjë

Është shumë mirë të jesh personi ku të gjithë kolegët drejtohen për të zgjidhur problemet e punës, por kjo mund t'ju largojë nga puna juaj. Caktoni një orar kur nuk duhet të shqetësoheni nga askush, por duhet të merreni vetëm me punen tuaj funlsionale. Nëse punoni në një zyrë të hapur, me kolegët rrotull, shkoni në sallën e mbledhjeve, ku nuk do të jetë aq e vështirë të gjeni qetësinë e kërkuar dhe kështu të organizoni punën më së miri. Nëse nuk arrini dot të siguroni një sallë të lirë, një zgjidhje do të ishte të vinit në vesh një palë kufje. Ju sigurisht nuk jeni duke dëgjuar muzikë nëpërmjet kufjeve, por të tjerët kuptojnë se nuk mund të përgjigjeni. Mësohuni të thoni "jo". Nuk është nevoja të kërkoni falje ose të jepni shpjegime. Mjafton t'u bëni të ditur kolegëve që, për momentin, jeni i zënë dhe nuk keni kohë të lirë për t'iu përgjigjur pyetjeve të tyre. Çdo bashkëpunëtor i mirë do t'ju kuptojë.

2.Organizohuni

Është shumë e vështirë të përqëndrohesh në një punë kur tavolina është e mbushur me dokumenta të shpërndara gjithandej pa rregull dhe ndoshta të panevojshme për momentin. Kushtojini disa minuta nga koha juaj rregullimit të tryezës çdo mëngjes. Mbajini letrat e rëndësishme afër, ndërsa të tjerat sistemojini nëpër rafte. Hidhini gjërat që nuk ju nevojiten dhe largoni menjëherë lojrat apo fjalëkryqet. Kjo do t'ju kursejë patjetër dy orët që harxhoni duke kërkuar dokumentat apo lapsin.

3.Shkruajini detyrat tuaja

Ndonjëherë mjafton një memorie vizuale për të qendruar i fokusuar në detyrat tuaja. Bëni një ose disa lista që duhet t'ju ndihmojnë për t'u përqëndurar .Vendoseni planin tuaj pranë kompjuterit për të parë vazhdimisht si keni ecur dhe në çfarë pike keni arritur . Kjo do t'ju mbajë në korent dhe arritjet që do të vini re do t'ju bëjnë të ndjeheni mire sa herë të hiqni një detyrë nga listat.

4.Organizoni telefonatat

Përdorimi i telefonit është i domosdoshëm për shumicën e njerëzve që punojnë dhe ka mënyra për të qenë më i frytshëm duke përdorur këtë mjet pune. Fillimisht planifikoni telefonatat e rëndësishme, duke mbajtur shënime rreth pikave kryesore dhe pyetjeve që do të bëni. Kjo do të ulë numrin e telefonatave që do të duhej t'i bënit të njëjtit person për të njëjtin problem. Mos iu përgjigjini të gjitha telefonatava. Lini sekretarinë dhe merrini në telefon kolegët në një kohë më të përshtatshme, kur të jeni i lirë.

Përgatiti faqen Eriona Vangjeli

Tribuna sindikale

